



Lajmet e Fundit:

DVP Durrës – Vijnë kontrollet intensive për rritjen e parametrave të sigurisë dhe goditjen e paligjshmërisë



Lajmet

Operacionet

28/07/2021

Vlorë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Antena”, në pranga 1 shtetas

Finalizohet një tjetër operacion për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje.

Operacioni policor i koduar “Antena”, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Vlorë, çon në pranga 1 shtetas.

Sekuestrohen një armë zjarri, municion luftarak dhe fidanë narkotikë.

Në vijim të operacioneve të njëpasnjëshme, me qëllim evidentimin dhe goditjen e rasteve të tentativës për kultivim të bimëve narkotike dhe armëmbajtjes pa leje, bazuar në informacionet e siguruar në rrugë policore, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë bënë të mundur finalizimin me sukses të operacionit policor të koduar “Antena”.

Në kuadër të këtij operacioni, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit E. M., në lagjen “15 Tetori”, u gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pushkë, 260 fishekë, një pjesë përbërëse arme zjarri dhe fidanë kanabis në gota plastike, gati për t’u mbjellë.

Në vijim të veprimeve, u arrestua në flagrancë për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Kultivimi i bimëve narkotike”, shtetasi E. M., 36 vjeç, banues në lagjen “15 Tetori”.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për veprime të mëtejshme.



Share



Share



Share



Share



Email

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Tiranë – Vijon operacioni “Fati i lojërave”, bien në pranga 2 shtetas

Elbasan – Vihen në pranga 3 shtetas dhe procedohen penalisht 2 shtetas të tjerë, për vepra të ndryshme penale ▶